EcoAlbania

RAPORT

VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË ENERGJISË NË NDËRTESA PËRMES KONCEPTIT TË VARFËRISË ENERGJETIKE



SENIOR II

Mbështetje për Organizatat Mjedisore
të Shoqërisë Civile në Shqipëri

NJË SY PËR MJEDISIN!

EcoAlbania

RAPORT

VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË ENERGJISË NË NDËRTESA PËRMES KONCEPTIT TË VARFËRISË ENERGJETIKE

Përgatiti për botim:
Qendra për ruajtjen e ekosistemeve natyrore në Shqipëri
(EcoAlbania)

Punoi në shkrimin e materialit:
Ita Angoni

Redaktoi materialin:
Olsi Nika

Analiza Statistikore:
Dr. Eliana Ibrahimi

Layout
Ermal Shenaj

Kontribuan në shkrimin e materialit:
Ermelinda Mahmutaj
Lira Hakani
Herda Paço

Ky raport vlerësues është realizuar nga partnerët zbatues "Së bashku një sy për mjedisin!", mundësuar në kuadër të programit "Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile në Shqipëri" (SENIOR II), i cili zbatohet nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri dhe financohet nga Qeveria Suedeze.

Përmbajtja e raportit është përgjegjësi vetëm e Qendrës mjedisore EDEN në emër të partnerëve zbatues të projektit "Së bashku një sy për mjedisin!" dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Qeverisë Suedeze dhe/apo të REC Shqipëri.

Janar 2018

REC Shqipëri

Suedi Sverige

PËRMBAJTJA

HYRJE 4

PËRKUFIZIME 5

KONCEPTI I VARFËRISË ENERGJETIKE 6

BAZA LIGJORE 8

METODA 9

- Kampioni 9

- Grumbullimi i të dhënave 9

- Hedhja dhe përpunimi i të dhënave 9

REZULTATE DHE INTERPRETIME 11

A. FAMILJET 11

1. Përshkrimi i kampionit 11

1.1 Tipologjia e banesës 12

1.2 Përdorimi i energjisë elektrike 15

1.3 Kostoja e energjisë elektrike 17

B. NJËSI TË TJERA NDËRTESASH 19

2. Përshkrimi i kampionit 19

2.1. Tipologjia e ndërtesës 20

2.1.1. Institucione të edukimit publik 20

2.1.2. Administrata publike 21

2.1.3. Spitale, Qendra shëndetësore, Klinika private 23

2.2. Hotele 24

2.3. Të dhëna të përgjithshme 26

2.4. Përdorimi i energjisë elektrike 26

2.5. Kostoja e energjisë elektrike 28

INTERFERENCA 30

PËRFUNDIME 31

REKOMANDIME 32

SHTOJCA 33

1. Informacion për organizatat e rrjetit të vigjilencës mjedisore që kanë kryer studimin në tiranë 33

2. Fotografi nga vizitat në terren 34

PËRMBAJTJA

HYRJE

Vlerësimi i paraqitur, i pari i këtij lloji në Shqipëri që përdor konceptin e varfërisë energjetike, ecën në të njëjtën linjë me sfidën e rëndësishme të ditëve të sotme ndaj kërkesës së vazhdueshme të rritjes së konsumit të energjisë elektrike apo të formave të tjera të energjisë për të plotësuar nevojat e banorëve për përmbushjen e të gjitha aktiviteteve jetësore. Koncepti lidh në mënyrë të drejtëpërdrejt dhe të fortë qytetarin me mjedisin; bën të prekshme mundësitë e arta për standardin e jetesës që ofrohen përmes objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm; dhe shfaqet shumë aktual dhe i nevojshëm për realitetin shqiptar. Rrjeti i vigjilencës mjedisore "Një sy për mjedisin!" zhvillon këtë vlerësim në kuadër të projektit "Së bashku një sy për mjedisin" me mbështetje financiare të Ambasadës Suedeze në kuadër të Programit "Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile në Shqipëri (SENIOR II)" dhe i zbatuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit Shqipëri (REC).

Ky raport i vlerësimit të performancës së energjisë në ndërtesa në qytetin e Tiranës publikohet pas një pune kërkimore dhe vlerësuese për 6 muaj. Ai ka për qëllim kryesor të japë informacion tregues në lidhje me performancën e energjisë në sektorin e banesave në familje të zakonshme dhe ato në vështirësi ekonomike, institucione publike dhe private si një mjet i vlefshëm për të adresuar sfidat për përdorimin e qëndrueshëm të energjisë së pastër, me synim efiçencën e energjisë dhe minimizimin e ndikimit negativ në mjedis.

Raporti vlerëson tipologjinë e banesave, koston e energjisë elektrike kundrejt të ardhurave, përdorimin e energjisë elektrike dhe cilësinë e jetesës si një fenomen të lidhur ngushtë me varfërinë energjetike. Vlerësimi paraqet situatën në Tiranë, duke nxjerrë më në pah faktin që kostoja e faturës së energjisë elektrike shpesh është e papërballueshme nga familjet me të ardhura të ulëta dhe rëndon te familjet me të ardhura mesatare mujore mbi 50 000 lekë.

Rezultatet e këtij raporti faktojnë situatën aktuale në Tiranë dhe i hapin rrugën nxitjes së politikave dhe praktikave më të mira që sigurojnë efiçencën e energjisë, diversifikimin e burimeve për energji të pastër dhe me kosto të përballueshme nga qytetarët e shtresave të varfra dhe të mesme në Tiranë.

Falenderojmë të gjithë të intervistuarit dhe aktorët e përfshirë në informacionin e besuar për të realizuar këtë vlerësim gjithëpërfshirës dhe pioner.

PËRKUFIZIME



1. *Efiçenca e energjisë* është rezultati, në përqindje, i raportit ndërmjet sasisë së energjisë në dalje me sasinë e energjisë në hyrje dhe synon zvogëlimin e sasisë së energjisë të kërkuar për të siguruar shërbime dhe produktet

2. *Acquis Communautaire* (acquis) përfshin të gjithë legjislacionin e BE-së të miratuar nga institucionet e saj.

3. *Burime të rinovueshme të energjisë* janë burimet e rinovueshme jofosile të energjisë, si era, energjia diellore, energjia aerotermale, energjia gjeotermale, energjia hidrotermale dhe oqeanike, energjia hidrike, biomasa, gazi i përftuar prej vendgroposjes së mbetjeve, gazi i përftuar prej impianteve të trajtimit të ujërave të zeza dhe biogazi, siç është përcaktuar në legjislacionin në fuqi për burimet e energjisë së rinovueshme.

4. *Ndryshime klimatike.* Ndryshimi i klimës është një ndryshim në shpërndarjen statistikore të modeleve të motit, kur dhe sa zgjat ndryshimi për një periudhë kohore (dekada apo edhe miliona vite). Ndryshimi i klimës mund t'i referohet një ndryshimi në kushtet mesatare të motit, apo në kohë me ndryshimin e kushteve mesatare afatgjata (më shumë apo më pak ngjarje ekstreme të motit).

KONCEPTI I VARFËRISË ENERGJETIKE

Varfëri energjetike është situata në të cilën një familje nuk mundet të aksesojë shërbimet energjetike në shtëpi në një nivel të atillë që mund të përballojë nevojat e saj sociale dhe materiale[1]. Levat që përcaktojnë nëse jemi ose jo në varfëri energjetike janë: *efiçenca e energjisë në ndërtesa*, *kostoja e energjisë* dhe *të ardhurat familjare*. Për këtë arsye në vendet e Evropës, varfëria energjetike i referohet në mënyrë të përgjithshme situatës ku individët **nuk janë në gjendje të sigurojnë energjinë e nevojshme në banesë me një çmim të përballueshëm**. Koncepti është i fuqishëm dhe analizon tre shtylla të rëndësishme: *politikat e energjisë*, *politikat sociale* dhe *praktikat e efiçencës së energjisë* (Figura 1).



Figura 1: Tre shtyllat që ndërlidhen për konceptin e varfërisë energjetike

Nuk është një koncept thjesht fizik, por është i ndërlidhur me çdo aspekt tjetër të jetës duke qenë një nga faktorët kyç të ekzistencës së njerëzimit në kohët moderne. Në dekadat e ardhshme sektori i energjisë do të përballet me shndërrime të cilat lidhen me a) *ndryshimet klimatike* b) *sigurimin e furnizmimit me energji* dhe c) *varfërinë energjetike*[2]. Dy pikat e para janë koncepte dhe praktika më të studiuara dhe më të trajtuara në sektorin e politikave, si dhe në nivelin e informimit dhe ndërgjegjësimit qytetar, ndërkohë që varfëria energjetike është një koncept shumë pak i njohur dhe i trajtuar edhe pse është i lidhur ngushtësisht me jetën e qytetarëve. Banesat rrezikohen nga varfëria energjetike si rezultat i pesë faktorëve[3]:

- Rritja e çmimit të energjisë elektrike është më e lartë në krahasim me rritjen e të ardhurave
- Pamundësia për të siguruar energji me çmim më të ulët
- Nevojat në rritje të familjeve për energji
- Mungesa e efiçencës në përdorimin e energjisë
- Ndërhyrjet e politikave

Varfëria energjetike është çështje e ndërlikuar që përbën një sfidë në adresim dhe në kuptim. Janë shumë faktorë që përcaktojnë nëse një familje përballet ose jo me efektet negative të këtij fenomeni (Figura 2)[4].

1. Bouzarovski et al. 2010
2. Preston et al. (2014): Fuel and poverty: A Rapid Evidence Assessment for the Joseph Rowntree Foundation. Centre for Sustainable Energy (CSE) "Karburanti dhe varfëria: Një vlerësim i shpejtë i evidencave për Fondacionin Joseph Rowntree. Qendra për Energji të Qëndrueshme (CSE)
3. Preston et al. (2014): Fuel and poverty: A Rapid Evidence Assessment for the Joseph Rowntree Foundation. Centre for Sustainable Energy (CSE) "Karburanti dhe varfëria: Një vlerësim i shpejtë i evidencave për Fondacionin Joseph Rowntree. Qendra për Energji të Qëndrueshme (CSE)
4. S. Robic (2016): Varfëria energjetike në Evropën Juglindore: Të mbijetuarit gjatë të ftohtit

Politikëbërësit preferojnë të përdorin konceptin e varfërisë energjetike si një fenomen të lidhur me shtresat me të ardhura të ulta. Kjo përqasje është e rëndësishme për të kanalizuar burimet te shtresat më në nevojë dhe pasqyron faktin që disa sisteme matëse të përdorura për vleresimin e varfërisë energjetike klasifikojnë dhe familjet me të ardhura të mesme apo të ulta si të varfëra energjetikisht. Por, **varfëria energjitike është një koncept i nevojshëm për të kategorizuar grupet që kanë presion financiar si pasojë e faturës së energjisë elektrike, por që nuk konsiderohen të varfër nën përkufizimin e përgjithshëm të varfërisë**[5].

Studiuesit kështillojnë se në rastin kur problemi nuk adresohet dhe nuk trajtohet në mënyrën e duhur ka ndikime në përkeqësimin e shëndetit të banorëve, në thellimin e varfërisë madje deri në pengimin e politikave që adresojnë ndryshimet klimatike[6].

Figura 2: Faktorët që përshkruajnë varfërinë energjetike

Është e rëndësishme që ky koncept të njihet dhe të adresohet duke qenë se sigurimi i shërbimeve bazë të energjisë është kritik që komunitetet të mos vuajnë nga ndikimet negative të treguara më sipër. **Duke marrë masat e nevojshme, mund të shmanget që mbështetja financiare e familjeve në nevojë të rëndojë mbi buxhetin e shtetit**. Qeveria dhe rregullatorë të tjerë kanë për detyrë të mbrojnë komunitetet në nevojë dhe të parandalojnë kalimin e shtresave të ndryshme shoqërore në vulnerabël.

Mungesa e të dhënave në nivel kombëtar ndikon që ky koncept të jetë edhe më abstrakt në përshkrimin dhe trajtimin e tij[7]. Si rrjedhim, në kërkesën për ta adresuar atë sa më mirë dhe drejtë, **është e nevojshme një bazë e mirë e konsoliduar të dhënash,** pasi sigurimi i tyre është çelësi për të përcaktuar dhe raportuar situatën aktuale, si dhe për të drejtuar përpjekjet dhe masat që duhet të ndërmerren në të ardhmen.

5. Hills, J. (2012): Getting the measure of fuel poverty: Final Report of the Fuel Poverty Review. CASE report 72. ISSN 1465 - 3001. Centre for Analysis of Social Exclusion, London School of Economics and Political Science
6. www.ec.europa.eu/energy/sites/ener/files/documents/Selecting%20Indicators%20to%20Measure%20Energy%20Poverty.pdf
7. Ky studim sipas këtij koncepti është kryer në të gjithë rajonin e ish Jugosllavisë nga organizatat mjedisore dhe për herë të parë propozohet në Shqipëri. Reduce Energy use And Change Habits www.reach-energy.eu

BAZA LIGJORE

Në kuadër të *acquis communautaire* ideja e varfërisë energjetike për herë të parë ka hyrë në kornizën ligjore të Bashkimit Evropian (BE) përmes të ashtuquajturës "Paketa e Tretë Energjetike" ku u përkufizua mbrojtja e konsumatorëve me qëllim uljen e varfërisë energjetike. Në bazë të Direktivave të Tregut të Brendshëm të BE-së për Energjinë Elektrike (2009/72/EC) dhe Gazin Natyror (2009/73/EC), shtetet anëtare duhet të përkufizojnë varfërinë energjetike dhe të mbrojnë konsumatorët e energjisë.

Në kuadër të procesit të integrimit, edhe në sektorin e energjisë baza ligjore e vendit po ngrihet duke përafruar legjislacionin e BE-së. Prej vitit 2006 Shqipëria është pjesë e Komunitetit të Energjisë[8] dhe si e tillë është e detyruar të përmbushë detyrimet që përmban ky anëtarësim. Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës (MEI) është organi kompetent për hartimin e legjislacionit dhe për raportimet në Komunitetin e Energjisë.

Me adoptimin e ligjit **Për efiçencën e energjisë**[8] i cili ka për qëllim hartimin e rregullave dhe politikave kombëtare për nxitjen, promovimin e përmirësimin e përdorimit efiçent të energjisë, me synim kursimin e energjisë dhe rritjen e sigurisë së furnizimit, si dhe heqjen e pengesave në tregun e energjisë dhe vendosjen e objektivave kombëtarë të efiçencës së energjisë, është miratuar formalisht krijimi i Agjencisë së Eficencës së Energjisë në dhjetor 2016. Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, pika 1, të ligjit për efiçencën e energjisë është miratuar nga Këshilli i Ministrave **Plani i dytë dhe i tretë Kombëtar i Veprimit për Efiçencën e Energjisë për Shqipërinë (PKVEE), 2017–2020**[9] i cili synon të ofrojë një vështrim gjithëpërfshirës mbi statusin e zbatimit dhe planet e ardhshme të politikave për efiçencën e energjisë në Shqipëri, si dhe përputhshmërinë e tyre me angazhimet e vendit në kuadrin e Komunitetit të Energjisë.

Në përputhje me detyrimet e Shqipërisë në Komunitetin e Energjisë është miratuar ligji **Për burimet e energjisë së rinovueshme**[10] përafruar plotësisht me Direktivën 2009/28/KE si dhe është miratuar **Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme (PKVBER)**[11], i cili përcakton objektivin që, deri në 2020, 38% e konsumit final të energjisë të jetë nga burimet e energjive të rinovueshme dhe përcakton masat e synuara për përmbushjen e tij. Më tej, në 2017, është miratuar ligji **Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme**[12] përafruar pjesërisht me Direktivën 2009/28/KE. Ai nxit rritjen e prodhimit të energjisë prej burimeve të rinovueshme për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm në Republikën e Shqipërisë.

Në vitin 2015 është miratuar ligji **Për sektorin e energjisë elektrike**[13]. Qëllimi i këtij ligji është garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

Duke filluar prej datës 1 janar 2015 ka filluar mënyra e re e tarifimit të energjisë elektrike duke mos patur më përshkallëzime të çmimit të energjisë elektrike për familjarët me dy nivele, nën dhe mbi 300 kWh, dhe të gjithë konsumatorët familjarë të energjisë elektrike do të paguajnë 9.5 lekë për kWh pa tvsh. **Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 kWh në muaj,** këshilli i ministrave ka miratuar një vendim të posaçëm i cili kompenson diferencën e çmimit të energjisë elektrike për mbrojtjen e këtyre shtresave[14].

Një ndër sukseset më të fundit të qeverisë është pikërisht plotësimi i mëtëjshëm i paketës së efiçencës së energjisë. Në nëntor të vitit 2016 është adoptuar nga parlamenti shqiptar ligji **Për performancën e energjisë së ndërtesave**[15] përafruar pjesërisht me direktivën 2010/31/BE, i cili ka për qëllim krijimin e kuadrit ligjor për përmirësimin e performancës së energjisë së ndërtesave, duke marrë në konsideratë kushtet lokale dhe klimaterike të vendit, kushtet e komfortit të brendshëm të ndërtesave, si dhe kostot efektive.

8. Ligji nr. 124/2015 "Për efiçencën e energjisë"
9. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 709, datë 1.12.2017 Për miratimin e planit të dytë dhe të tretë kombëtar të veprimit për efiçencën e energjisë për Shqipërinë 2017–2020 www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2017/PDF-2017/214-2017.pdf
10. Ligji nr. 26/2014 Për disa ndryshime në ligjin nr. 138/2013 "Për burimet e energjisë së rinovueshme"
11. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 20.1.2016 "Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme 2015 – 2020"
12. Ligj nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"
13. Ligj nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike"
14. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 14.1.2015 "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWh në muaj"
15. Ligji nr. 116/2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave"

METODA

Vlerësimi i varfërisë energjetike është kryer në periudhën korrik – shtator 2017 në 5 qytete të vendit: Shkodër, Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Berat[16], të cilat kanë shtrirje gjeografike si dhe profile të ndryshme. Grupi i synuar përfaqëson 6 kategori: 1) Familje vulnerabël 2) Familje të zgjedhura rastësisht 3) Institucione edukimi publik (çerdhe, kopshte, shkolla, universitete) 4) Administrata publike 5) Institucione shëndetësore publike dhe 6) Hotele.

Kampioni

Kampioni i marrë për vlerësim përfaqësohet nga **1954** njësi të shpërndara sipas figures 3[17] dhe tabelës më poshtë:

GRUPI I SYNUAR	QYTETI					TOTAL
	TIRANA	BERAT	VLORË	ELBASAN	SHKODRA	
Familje vulnerabël	110	29	40	45	49	273
Familje në përgjithesi	502	159	221	193	191	1266
Total njësi ekonomike familjare	**612**	**188**	**261**	**238**	**240**	**1539**
Institucione edukimi publik *(çerdhe, universitet, shkolla, kopsht)*	56	20	24	20	20	140
Administrata publike	55	15	9	15	15	109
Institucione shëndetësore publike	20	6	1	7	7	41
Hotele	60	20	5	20	20	125
Total njësi të tjera	**191**	**61**	**39**	**62**	**62**	**415**
TOTAL	**803**	**249**	**300**	**300**	**302**	**1954**

Tabela 1. Shpërndarja e kampionit për secilin qytet

Përmasa e kampionit së përzgjedhur për secilin qytet është llogaritur për të siguruar një rezultat statistikisht të besueshëm në nivelin 95% mbështetur edhe në popullsinë e secilës njësi bashkiake sipas të dhënave të censusit 2011. Përmasa për nëngrupet me interes krahasimi është marrë minimalisht 100, niveli minimal i pranuar statistikisht.

- Grumbullimi i të dhënave

Për grumbullimin e të dhënave është përdorur një pyetësor i huazuar dhe përshtatur nga projekti REACH[18] i cili ka bërë këtë vlerësim për të gjitha shtetet e ish-Jugosllavisë. Në Shqipëri është hera e parë që zhvillohet ky studim. Pyetësori për njësitë familjare përmban 50 pyetje: 18 pyetje me karakter socio-ekonomik dhe shëndetësor, dhe 32 pyetje me karakter energjetik. Ndërsa pyetësori për njësitë e tjera[19] përmban vetëm 32 pyetjet me karakterin energjetik.

Metoda e grumbullimit ka qenë me intervista të drejtpërdrejta në zonën e përcaktuar për të realizuar vlerësimin, zona urbane brenda njësisë bashkiake. Anektuesit (24) u trajnuan dhe testuan paraprakisht pyetësorin. Familjet u përzgjodhën rastësisht duke patur parasysh ndarjen administrative të secilit qytet, por me një shpërndarje gjeografike dhe me tipologji banese të ndryshme. Familjet vulnerabël janë përzgjedhur sipas një liste nga komunikimi zyrtar me Drejtoritë Bashkiake të Shërbimeve Sociale të secilit qytet, dhe në rastet e mungesës së listave është bashkëpunuar me Organizatën Shoqërore të Përkrahjes së të Rinjve (ARSIS) si dhe janë zhvilluar pyetësorët në godinat sociale bashkiake. Hotelet, institucionet e edukimit publik, institucionet e shëndetit publik dhe administrata publike janë përzgjedhur rastësisht.

- Hedhja dhe përpunimi i të dhënave

Në programin SPSS (Paketa Statistikore për Shkencat Sociale) version 20 (IBM statistics 2011) u ngrit një databazë e posaçme për vlerësimin, prej nga u hodhën dhe u përpunuan të dhënat. Paraqitja grafike e të dhënave është realizuar me paketën Microsoft Excel 2010. Hartat janë ndërtuar në Q-Gis dhe Ilustrator.

16. Për t'u informuar rreth raporteve vlerësuese për secilin qytet gjeni në shtojcë kontaktet e secilës organizatë për qytet
17. Hartat e shpërdarjes së kampionit sipas koordinatave GPS paraqiten në kapitullin "Rezultate dhe Interpretime"
18. REACH www.reach-energy.eu (Reduce Energy use And Change Habits) zbatuar në Bullgari, Kroaci, Maqedoni, Sllloveni).
19. Në vijimësi për lehtësi përshkrimi do të përdoret fjala institucione për kategorinë "njësi të tjera"

SHPËRNDARJA E KAMPIONIT

QYTETE	NJËSI EKONOMIKE FAMILJARE	NJËSI TË TJERA	TOTALE
TIRANË	612	191	803
SHKODËR	240	62	302
ELBASAN	238	62	300
BERAT	188	61	249
VLORË	261	39	300



Figura 3: Shpërndarja e kampionit

REZULTATE DHE INTERPRETIME

A. FAMILJET

1. Përshkrimi i kampionit

Mostra për qytetin e Tiranës përfshin 11 Njësi Bashkiake, me 612 njësi ekonomike familjare të anketuara të shpërndara sipas *Hartës nr. 1.* Numri më i madh i të anketuarve janë të gjinisë femër me pjesëmarrje 53%, kundrejt meshkujve me pjesëmarrje 47%. Mosha mesatare e të anketuarve është rreth 42 vjeç nga të cilët 70% janë të martuar apo bashkëjetojnë, nga këta 38% rezultojnë me arsim të lartë, ndjekur nga 37% me arsim të mesëm. Ndërkohë vetëm 1% e të intervistuarve nuk kanë ndjekur shkollë. Të pyetur për të ardhurat mujore, rezulton se më shumë se gjysma e të intervistuarëve (52%) kanë të ardhura neto deri në një maksimum prej 35 000 lekë. Të ardhura mujore nën 10 000 lekë sipas këtij studimi rezulton të kenë 13% e personave të anketuar.

HARTA E SHPËRNDARJES - TIRANË



Harta nr. 1. Shpërndarja e mostës së marrë në studim (612 familje dhe 191 institucione) në qytetin e Tiranës.

TË ARDHURAT MESATARE MUJORE NETO	FAMILJET E ANKETUARA (NË PËRQINDJE)
Nën 10 000 lekë	6.9
10 000 – 25 000 lekë	11.9
25 000 – 35 000 lekë	11.9
35 000 lekë – 50 000 lekë	15.7
Mbi 50 000 lekë	51.0

Tabela nr. 2. Të ardhurat mesatare mujore neto në familjet e anketuara.

Situata ndryshon lehtësisht për të ardhurat kumulative në familje *(tabela nr. 2)*. Sipas të dhënave të studimit, 51% e familjeve kanë të ardhura mestare mujore mbi 50 000 lekë, ndërkohë që rreth 7% e familjeve kanë të ardhura nën 10 000 lekë. Nga 612 familjet e marra në studim në qytetin e Tiranës, kanë në banesë mesatarisht 1 fëmijë nën 12 vjeç dhe një të moshuar mbi 60 vjeç.

Pjesa më e madhe e familjeve të anketuara (rreth 80%), banojnë në apartamente me sipërfaqe mesatare 61 – 90 m^2 dhe janë pronarë të banesave të tyre (69% e kampionit).

Studimi tregon se rreth 43% e familjeve në qytetin e Tiranës kanë vështirësi në pagesën e energjisë elektrike në banesat e tyre. Megjithatë, të pyetur nëse do t'u jepej mundësia për të lëvizur në një hapsirë tjetër më të përshtashme, 56% e tyre janë përgjigjur se nuk do lëviznin nga banesa e tyre aktuale. Ky mund të jetë tregues që familjet e Tiranës do të pëlqenin më shumë të ndërhynin në rikonstruktimin e banesave ku jetojnë sesa të lëvizin në banesa të tjera.

1.1 TIPOLOGJIA E BANESËS

Në qytetin e Tiranës, rezulton se pjesa më e madhe e familjeve të marra në studim jetojnë në banesa të ndërtuara 6 – 25 vite më parë (30% e kampionit). Ndërsa numri më i vogël i familjeve banon në ndërtesat e 5-vjeçarit të fundit (11%). Rreth 89% të banesave janë të kufizuara nga të dy anët me banesa të tjera, 8% të pakufizuara nga banesa të tjera, 2% në fund të bllokut të banuar dhe 2% janë kati i fundit i banimit. Nga anketimi ka rezultuar se 28% e familjeve kanë më pak se 5 vite që banojnë në shtëpitë ku ndodhen në kohën e studimit dhe 28% kanë mbi 20 vite që jetojnë në atë banesë, të ndjekur nga 26% që jetojnë aty prej 6 – 10 vitesh dhe 17% prej 11 – 20 vitesh.

IZOLIMI I NDËRTESËS



Figura nr. 4. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesës dhe shkallës së izolimit të saj.

Në mostën e marrë në studim është vlerësuar raporti që ekziston ndërmjet vjetërsisë së ndërtesave dhe izolimit të tyre *(figura nr. 4)*. Nga të dhënat rezulton se banesat me vjetërsi 6 – 25 vite arrijnë përqindjen më të lartë (32%) për izolimin e plotë (mure, çati, dysheme) dhe ndërtesat e 5 viteve të fundit zënë vetëm 17 % në izolimin e plotë. Banesat midis viteve 1982 dhe 1991 kanë numrin më të lartë të ndërtesave të cilat nuk kanë izolim (59%). Siç duket nga grafiku i *fig. nr. 4,* ndërtesat e viteve 1992 – 2011 janë ato të cilat ofrojnë një komfort termik më të lartë.

IZOLIMI I SHTËPISË / NDËRTESËS - TIRANË



Harta nr. 2. Shpërndarja ndërtesave sipas shkallës së izolimit të tyre në qytetin e Tiranës.

Në *hartën nr. 2* paqitet shpërndarja e banesave sipas shkallës së tyre të izolimit për 612 familjet dhe 191 institucionet e marra në studim në qytetin e Tiranës. Duket se nuk ka një model të caktuar që përcakton lidhjen ndërmjet pozicionit gjeografik të ndërtesës dhe shkallës së izoimit të saj. Duke qenë se korniza e dritareve ka ndikim të drejpërdrejt në përçimin e nxehtësisë, është analizuar lidhja e moshës së banesave me llojin e materialit të kornizës së dritares *(figura nr. 5).* Siç duket nga grafiku, ka një trend zbritës në përdorimin e drurit për kornizën e dritare. Kornizat prej druri në dritare mbizotërojnë në banesat e ndërtuara mbi 60 vite më parë (21%), ndjekur nga ato të ndërtuara 36 – 60 vite më parë (11%), 26 – 35 vite më parë (6%) dhe 6 – 25 vite (6%). Në ndërtesat e 5 viteve të fundit nuk ka përdorim të këtij materiali. Vihet re që në gjithë grupet e ndërtesave të marra në studim mbizotëron dukshëm përdorimi i kornizave prej alumini në dritare. Trendi është rritës për përdorimin e këtij materiali në 35 vitet e fundit. Kjo shpjegohet jo domosdoshmërisht me preferencën e ndërtuesëve, por me ndërhyrjet restauruese që kanë bërë vetë familjet, si dhe me mbizotërimin e këtij materiali në treg.

KORNIZA E DRITARES



Figura nr. 5. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesës dhe materialit në kornizën e dritares.

Numrin më të lartë të banesave me tipin e xhamave teke në dritare e zënë ato të ndërtuara mbi 60 vite më parë (68%) *(figura nr. 6).* Ndërkohë që të njëjtat banesa paraqesin mungesë të plotë për izolimin e xhamave në dritare. Ndërtesat e pesë viteve të fundit zënë numrin më të lartë të pajisjes me xhama dopio në dritaret e tyre (83%), njëkohësisht janë po të njëjtat që kanë numrin më të ulët të xhamave teke (15%). Në banesat e ndërtuara pas viteve 1950 xhamat e izoluar zënë vetëm 2% për secilën kategori ndërtesash.

TIPI I XHAMAVE NË DRITARE



Figura nr. 6. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesës dhe tipit të xhamave të saj.

Prania e dritareve dhe dyerve ku kalojnë rryma ajri është një tipar i vlefshëm për t'u marrë në shqyrtim kur vlerësohet performanca e energjisë së banesave. Në *figurën nr. 7* paraqitet lidhja e moshës së banesave dhe pranisë së dritareve ku kalojnë rryma ajri. Ndërtesat më të vjetra se 60 vite kanë përqindjen me të lartë të dritareve ku kalojnë rryma ajri (62% e kampionit), ndërkohë që ato të ndërtuara 5 vitet e fundit kanë përqindjen më të ulët (9%). Vihet re që në ndërtimet e 25 viteve të fundit dritaret ku kalojnë rryma ajri janë në numër të vogël krahasuar me praninë e tyre në ndërtimet e para 25 viteve.

DRITARE KU KALOJNË RRYMA AJRI



Figura nr. 7. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesës dhe pranisë së dritareve ku kalojnë rryma ajri.

Po e njëjta situatë paraqitet edhe për dyert ku kalojnë rryma ajri *(fig. nr. 8)*. Në qytetin e Tiranës, ndërtimet e më shumë se 60 viteve më parë, kanë përqindjen më të lartë të dyerve ku kalojnë rryma ajri (60%), krahasuar me ndërtesat e 5 viteve të fundit të cilat zënë përqindjen më të vogël (11%). Si në rastin e dritareve, ashtu edhe për dyert ku kalojnë rryma ajri, duket se trendi është në zbritje nga ndërtesat më të vjetra në ato më të reja.

DYER KU KALOJNË RRYMA AJRI



Figura nr. 8. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesës dhe pranisë së dyerve ku kalojnë rryma ajri.

1.2 Përdorimi i energjisë elektrike

Rreth 79% e familjeve të marra në studim shprehen se gjatë stinës së dimrit ngrohin dhe përdorin vetëm një dhomë në varësi të periudhës së ditës. Duket se kjo sjellje për reduktimin e shpenzimeve të energjisë elektrike bën që rreth 68% e të anketuarve të shprehen se janë të kënaqur me temperaturën në banesën e tyre gjatë stinës së dimrit. Por, nuk duhen anashkaluar 32% e familjeve të anketuara të cilat tregojnë pakënaqësi në temperaturën e banesës së tyre gjatë stinës së dimrit. Lagështia duket se nuk është një faktor shqetësues për rreth 78% të familjeve pasi ata shprehen të kënaqur me cilësinë e ajrit (lagështinë) në banesat e tyre.

Mënyra sesi përdoret energjia elektrike ka ndikim të drejtpërdrejt në faturën e energjisë. Nga mostra e marrë në studim në qytetin e Tiranës rezulton se 68% e familjeve përdorin energjinë elektrike për ngrohje dhe 63% për ftohje të ambientit të brendshëm të banesës së tyre. Për ngrohjen e ujit përdorimi i energjisë elektrike është edhe më i lartë, me rreth 95% të totalit të familjeve të marra në studim. Nga të dhënat e mësipërme kuptojmë se ekziston nevoja e diversifikimit të burimeve të energjisë që familjet në Tiranë përdorin ngrohjen dhe ftohjen e ambjentit, si dhe ngrohjen e ujit. Rreth 46% e familjeve të anketuara përdorin vetëm energjinë elektrike për gatim. Kjo është një shifër mjaft e lartë nëse marrim parasysh edhe familjet që përdorin alternim të energjisë elektrike me gazin apo me biomasën. Të dhënat e paraqitura në *figurën nr. 9* tregojnë se vetëm 23% përdorin metoda të tjera për ngrohjen e ambientit të brendshëm, siç mund të jetë përdorimi i sobës me gaz, dru, peleta apo janë të pajisur me ngrohje qendrore në ndërtesën e tyre.

Situata nuk ndryshon shumë kur flitet mbi përdorimin e energjisë elektrike për ftohjen e ambientit të brendshëm të banesës (*fig. nr. 9*), ku reth 62% e të anketuarve shprehen se përdorin energjinë elektrike. Nga puna në terren dhe bisedat me disa nga personat të cilët nuk përdorin energji elektrike për ftohje, na është thënë se mënyrat e tjera që përdorin janë lënia e dyerve dhe dritareve hapur, kufizimi i qëndrimit në shtëpi vetëm në njërën dhomë ku nuk bie dielli, etj. Kjo situatë është me e theksuar në familjet vulnerabël të qytetit të Tiranës.

PËRDORIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE



Figura nr. 9. Përdorimi i energjisë elektrike për ngrohjen e banesës.

Përafërsisht 95% e familjeve në Tiranë, përdorin energjinë elektrike për ngrohjen e ujit (*fig. nr. 9*). Përqindja e lartë e përdorimit të energjisë elektrike për ngrohjen e ujit mund të jetë një ndër fatorët që ndikon në rritjen e shpenzimeve të faturës së energjisë edhe gjatë stinës së verës. Gjithashtu, kjo përqindje e lartë shpjegohet edhe me mënyrën e përdorimit të ujit të ngrohtë nga ana e qytetarëve. Gjatë punës në terren për mbledhjen e të dhënave, na është thënë se shishet me ujë të ngrohtë përdoren për tu ngrohur gjatë stinës së dimrit duke u munduar të zëvendësojnë përdorimin e kondicionerit apo ngrohëses.

Në *figurën 10* dhe *11* paraqiten të dhënat për mënyrën e ngrohjes së ujit në banjë dhe kuzhinë. Në të dy rastet mbizotëron përdorimi i energjisë elektrike. Në ndryshim nga ngrohja e ujit në banjë (ku 95% e familjeve përdorin energjinë elektrike), në kuzhinë alternohen energjia elektrike me gazin apo biomasën. Me qëllim pakësimin e shpenzimeve, 24% e familjeve të anketuara janë shprehur se nuk e ngrohin ujin në kuzhinë.

NGROHJE E UJIT NË BANJË



Figura nr. 10. Mënyra e ngrohjes së ujit në banjë.

NGROHJE E UJIT NE KUZHINË



Figura nr. 11. Mënyra e ngrohjes së ujit në kuzhinë.

Vlen për t'u përmendur përdorimi i energjisë diellore nga familjet e qytetit të Tiranës. Rreth 2% e familjeve përdorin panele diellore për ngrohjen e ujit në banjë, si dhe rreth 2% për ngrohjen e ujit në kuzhinë. Këto shifra tregojnë interesin që kanë familjet në Tiranë për përdorimin e këtij burimi energjie duke e parë si më ekonomik. Arsye kjo e cila i ka çuar familjet të investojnë në instalimin e paneleve diellore.

Nga figura nr. 12 duket se një pjesë e mirë e banorëve të Tiranës marrin masa për reduktimin e kostos së energjisë elektrike në banesat e tyre. Ata janë pyetur për disa nga mënyrat që kanë përdorur gjatë dimrit të vitit 2016 - 2017. Ngrohja dhe përdorimi i vetëm një dhome në varësi të periudhës së ditës është një praktikë e përdorur nga rreth 80% e familjeve të anketuara. Po ashtu, rreth 75% e të anketuarve shprehen se e reduktojnë ngrohjen edhe pse do të preferonin të ishte më ngrohtë. Një tregues i vështirësisë që hasin familjet e Tiranës është fakti se më tepër e gjysma e tyre (51,3%) përdorin më pak ushqim dhe pije të ngrohta sesa do të dëshironin.

Koncepti i varfërisë energjetike përfshin konsumin e më pak energjie elektrike sesa nevojitet. Siç duket edhe nga të dhënat e mbledhura nga ky studim, familjet në qytetin e Tiranës ndodhen në një situatë reale varfërie energjetike.



Figura nr. 12. Masat e përdorura dimrin e vitit 2016 – 2017 për reduktimin e kostos së energjisë elektrike.

1.3 KOSTOJA E ENERGJISË ELEKTRIKE

Të ardhurat mesatare mujore	Shpenzime mesatare mujore për energji elektrike	% e te ardhurave qe shkojne per faturen e energjise elektrike
Nën 10.000 lekë	~ 4.800 lekë	48.11
10.000 – 25.000 lekë	~ 4.700 lekë	26.75
25.000 – 35.000 lekë	~ 5.500 lekë	18.27
35.000 lekë – 50.000 lekë	~ 5.600 lekë	13.23
Mbi 50.000 lekë	~ 6.500 lekë	13.01

Tabela nr. 3. Shpenzimet mesatare mujore për energji elektrike për secilin grup të ardhurash mujore në familje.

Familjet e kampionit të marrë në studim kanë të ardhura mesatare mujore që luhaten nga më pak se 10.000 lekë në muaj deri në mbi 50.000 lekë në muaj. Shpenzimet mesatare mujore për energjinë elektrike në secilin grup paraqiten në *Tabelën nr. 3*. Vihet re se familjet të cilat kanë të ardhura mujore më të larta kanë edhe kosto mesatare mujore të energjisë elektrike më të lartë krahasuar me familjet me të ardhura më të ulëta. Një luhatje të lehtë në grupin me të ardhura mesatare mujore 10.000 – 25.000 lekë të cilët paraqesin një rënie të vogël.

Familjet me të ardhura mesatare mujore mbi 50.000 lekë në krahasim me familjet me të ardhura mujore nën 10.000 lekë, paguajnë një kosto mesatare mujore të energjisë vetëm 1.4 herë më shumë. Nga këto shifra duket qartësisht vështirësia që kanë familjet me të ardhura të ulëta në përballimin të shpenzimeve të tjera jetësore përveç pagesës së faturës së energjisë elektrike.

Në *figurën nr. 13* është analizuar lidhja që ekziston ndërmjet të ardhurave mesatare mujore në familje dhe shpenzimeve për energjinë elektrike për muajt e dimrit dhe të verës. Kostoja mesatare e energjisë elektrike e paguar në dimër është më e lartë se kostoja mesatare e energjisë elektrike paguar në verë për të gjitha familjet. Tarifa mesatare mujore në dimër e cila rezulton të jetë 7.270 lekë dhe tarifa mesatare mujore në verë rezulton 4.936 lekë. Shpenzimet për pagesën e energjisë elektrike janë më të larta në familjet me të ardhura mbi 50.000 lekë me një mesatare prej rreth 8.000 lekë për muajt e dimrit dhe 5.000 për muajt e verës.

Në familjet me të ardhura nën 10.000 lekë, pagesa mesatare për stinën e dimrit është 6.300 lekë, ndërsa për muajt e verës 3.700 lekë. Kjo sitatë shkon përtej shifrave kur mendohet pjesa që kjo pagesë zë në të ardhurat e përgjithshme të familjeve me të ardhura të ulta. Gjatë mbedhjes së të dhënave në familjet vulnerabël është hasur një rast i veçantë. Nga biseda me zonjën e shtëpisë ajo u shpreh se nuk kishte energji elektrike prej 7 vitesh dhe as nuk ishte pajisur me matës për energjinë elektrike pavarësisht kërkësave të vazhdueshme të saj ndaj zyrës përgjegjëse në zonën ku ajo banon.

ÇMIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE



Figura nr. 13. Trendi i shpenzimeve të faturës së energjisë elektrike lidhur me të ardhurat mujore të familjes

Familjet e marra në studim janë pyetur nëse hasin vështirësi në pagesën e faturës për ujin, gazin, energjinë elektike, si dhe për shpenzimet e ngrohjes kur përdoren metoda të tjera përveç energjisë elektrike. Siç shihet në figurën nr. 14, vështirësia më e madhe është ajo për pagesën e elektricitetit (43%), e ndjekur nga ajo e ujit (35%), ngrohja (31%) dhe në fund pagesa për gazin (26%). Kjo mund të jetë e lidhur me çmimin për secilën katëgori shpenzimesh. Për konsumatorët familjarë, çmimi në treg për kWh energji elektrike është më i lartë se ai për m³ ujë, dhe ky i fundit më i lartë se ai për litër gaz.

Nën kategorinë "e pazbatueshme" verejmë se përqindjen më të lartë e zë fatura për gazin (25%), ndjekur nga zëri ngrohje (19%). Ky rezultat mund të jetë i tillë për shkak se 25% e familjeve të anketuara nuk përdorin gazin në shtëpitë e tyre, si dhe 19% nuk përdorin metoda të tjera ngrohje përveç energjisë elektrike. Efekti kumulativ e thekson situatën, me 44% të totalit të familjeve nuk përdorin as gazin dhe as metoda të tjera për ngrohje përveç energjisë elektrike.

VËSHTIRËSI NË PAGESËN E FATURËS PËR



Figura nr. 14. Vështirësia e familjeve të Tiranës për pagesën e faturës për ujin, energjinë elektrike, gazin dhe ngrohjen.

B. NJËSI TË TJERA NDËRTESASH

2. Përshkrimi i kampionit

Në qytetin e Tiranës janë marrë në studim 191 njësi të tjera ndërtesash. Në *tabelën nr. 4* jepet numri për secilën kategori institucionesh të anketuara. Institucione të edukimit publik (çerdhe, kopshte, shkolla dhe institucione universitare) përfaqësohen me 56 ndërtesa; 55 nga administrata publike (ministritë dhe drejtoritë në varësi të tyre); 20 janë spitale publike, qendra shëndetësore, poliklinika dhe klinika private; dhe biznesi privat përfaqësohet me 60 hotele.

Vihet re se numri më i madh i ndërtesave janë më të vjetra se gjashtë vjeçare (*figura nr. 15*), ndërkohë që vetëm 4% janë ndërtuar 5 vitet e fundit. Në studimin tonë rezulton se numri më i madh i ndërtesave të përdorura jo për qëllime banimi janë janë ato të viteve 1992 - 2011, kohë e cila përkon me fuqizimit të pronës private dhe zhvillimin e sektorit të ndërtimit.

Punonjësit e anketuar në pjesën më të madhe të institucioneve kanë qenë përfaqësuesit e departamentit të financave, ekonomistët, si dhe menaxherët në rastin e hoteleve. Vështirësi është hasur në gjetjen e personave përgjegjës për financat në çerdhet dhe kopshtet e Tiranës, pasi të ardhurat menaxhohen nga Bashkia Tiranë. Pas 2-3 vizitash dhe pamundësisë për të folur me një ekonomist, pyetësori është plotësuar nga punonjës në dijeni të shpenzimeve në institucion.

INSTITUCIONI	NUMRI I MARRË NË ANALIZË
Institucione të edukimit publik	56
Administrata publike	55
Spitale publike, qendra shëndetësore, poliklinika, klinika private	20
Hotele	60
Totali	191

Tabela nr. 4. Kategoria dhe numri i institucioneve të marra në studim.

MOSHA E NDËRTESAVE



Figura nr. 15. Mosha e ndërtesave të marra në studim.

2.1 TIPOLOGJIA E NDËRTESËS

2.1.1 Institucione të edukimit publik

Në *figurën nr. 16* analizohet lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe shkallës së izolimit të tyre. Sigurimi i kushteve të favorshme në ndërtesat e edukimit publik mund të konsiderohet tregues i mirëqënies së një qyteti. Vetëm gjysma e ndërtesave të 5 viteve të fundit kanë izolim të plotë të tyre, ndërkohë që gjysma tjetër nuk kanë izolim. Në gjendje më të mirë përsa i përket izolimit janë ndërtesat me moshë 6 – 25 vite, nga të cilat 70% kanë izolim të plotë dhe 20% janë pjesërisht të izoluara. Duket se edhe për ndërtimet më të vjetra se 60 vite janë marrë masa për izolim. Prej tyre, 29 % paraqesin izolim të plotë dhe 57% izolim të pjesshëm. Të dhënat tregojnë se nevojitet një punë më e mirë në izolimin e ndërtesave të reja. Në *figurën nr. 17* paraqitet lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe tipit të xhamave në dritare. Në *figurën nr. 18* paraqitet lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe kornizës së dritares. Ndërtimet e 5 viteve të fundit janë



Figura nr. 16. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe izolimit të tyre.

të gjitha të pajisura me xham dopio në dritare. Po të njëjtat ndërtesa tregojnë praninë e kornizës së dritares prej alumini (50% e kampionit) dhe plastike (50%), si dhe mungesë të plotë të kornizave prej druri. Grupi i ndërtesave me moshë 26 – 60 vite tregojnë dy të veçanta në raport me grupet e tjera. Nga njëra anë, janë të vetmet ndërtesa që kanë xhama të izoluar në dritare edhe pse ne përqindje të ulët (*fig. nr. 17*). Nga ana tjetër, janë po ashtu të vetmet ndërtesa që kanë korniza druri në dritare (*fig. nr. 18*), si dhe mungesë të plotë të kornizave plastike. Sipas të dhënave të paraqitura në dy grafikët më poshtë, vihet re një trend rritës 35 vitet e fundit për të pajisur dritaret me dopio-xham.



Figura nr. 17. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe tipit të xhamave në dritare.



Figura nr. 18. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe tipit të material të ornizave në dritare.

Ndërtesat e edukimi publik të marra në studim janë analizuar për praninë e dritareve dhe dyerve ku kalojnë rryma ajri. Lidhja ndërmjet vjetërsisë së ndërtesave dhe këtyre dy karakteristikave paraqitet në *figurat nr. 19* dhe nr. *20*. Ndërtesat e 5 viteve të fundit tregojnë gjendjen më të mirë. Asnjë prej tyre nuk paraqet prani të dyerve apo dritareve ku kalojnë rryma ajri. Ndërkohë që ndërtimet e mbi 60 viteve më parë kanë numrin më të lartë të dyerve (57%) dhe dritareve (29%) ku kalojnë rryma ajri. Kuptohet që këtu, nevoja për të ndërhyrë në izolimin e dyerve dhe dritareve në këtë grup ndërtesash është më e madhe.



Figura nr. 19. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe pranisë së dritareve ku kalojnë rryma ajri.

Figura nr. 20. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe pranisë së dyerve ku kalojnë rryma ajri.

2.1.2 Administrata publike

Ndërtesat e administratës publike tregojnë një trend rritës për izolimin e plotë të tyre nga më të vjertat tek më të rejat. Në ndërtesat e 5 viteve të fundit, 67% kanë izolim të plotë dhe 33% janë pjesërisht të izoluara (*figura nr. 21*). Izolim vetëm të mureve e gjejmë në grupet e ndërtesave me moshë 6 – 25 vite (20% e tyre) dhe 36 – 60 vite (12% e tyre). Prani të ndërtesave me mungesë të plotë të izolimit e vërejmë në të gjithë grupet e ndërtesave më të vjetra se 5 vite, me numrin më të lartë tek ato me 26 – 35 vite vjetërsi (38% të totalit të tyre). Në grupin e ndërtesave me mbi 60 vite vjetërsi ka një raport të njëjtë prej 33% midis atyre që kanë izolim të plotë, janë pjesërisht të izoluara apo mungon plotësisht izolimi.

Ashtu si në rastin e institucioneve të edukimit publik, edhe ndërtesat e përdorura nga administrata publike me vjetërsi 6 – 35 vite paraqesin dallim përsa i përket tipit të xhamave dhe korzinës së dritares (*fig. nr. 22* dhe *nr. 23*). Vetëm këto dy grupe ndërtesash kanë xhama të izoluar dhe praninë e kornizave prej druri, edhe pse në numër të ulët. Xhamat teke mbizotërojnë në të gjithë grupet e ndërtesave më të reja se



Figura nr. 21. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe izolimit të tyre

60 vite (*fig. 22*). Rreth 67% e ndërtesave të 5 viteve të fundit kanë xhama teke në dritaret e tyre, kundrejt 33% të pajisur me xhama dopio. Numrin më të lartë të ndërtesave me xhama teke e gjejmë tek ato me moshë 6 – 25 vite (80%), ndjekur nga ato 36 – 60 vite (71%). Ndërkohë që në ndërtesat më të vjetra se 60 vite, 42% kanë xhama teke dhe 58% kanë xhama dopio. Nga të dhënat e studimit rezulton se në gjithë grupet mbizotëron prania e kornizave prej alumini në dritare (*fig. nr. 23*). Në kampionin tonë, gjithë ndërtesat më të reja se 5 vite dhe mbi 36 vite kanë vetëm korniza alumini në dritare. Përdorimin e plastikës e ndeshim vetëm tek ndërtesat me moshë 26 – 35 vjeçare në një përqindje të vogël (13%). Druri përdoret në 20% të ndërtesave me moshë 6 – 25 vite dhe 6% në ato me 26 – 35 vite vjetërsi.

TIPI I XHAMAVE NË DRITARE



Figura nr. 22. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe tipit të xhamave në dritare.

KORNIZA E DRITARES



Figura nr. 23. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe materialit të kornizës në dritare.

Për sa i përket pranisë së dritareve dhe dyerve ku kalojnë rryma ajri, paraqesin ngjashmëri ndërtesat e administratës publike me moshë më të re se 5 vite dhe ato me të vjetra se 60 vite. Të gjithë ndërtesat e marra në studim të këtyre dy grupeve nuk kanë as dyer dhe as dritare ku kalojnë rryma ajri (*figura nr. 24* dhe *nr. 25*). 20% e ndërtesave me moshë 6 – 25 vite kanë dyer dhe dritare ku kalojnë rryma ajri, ndjekur nga ndërtesat me vjetërsi 26 – 35 vite me 13%. Rrymat e ajrit ulin shkallën e efiçencës energjetike së një ndërtese. Të dhënat tregojnë se duhet ndërhyrë në përmirësimin e gjendjes tek ndërtimet e kryera midis viteve 1957 dhe 2011.

DYER KU KALOJNE RRYMA AJRI



Figura nr. 24. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe pranisë së dritareve ku kalojnë rryma ajri.

DRITARE KU KALOJNE RRYMA AJRI



Figura nr. 25. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe pranisë së dyerve ku kalojnë rryma ajri.

IZOLIMI I NDËRTESËS



Figura nr. 26. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe izolimit të tyre

2.1.3 Spitale, qendra shëndetësore, klinika private

Të dhënat e studimit tregojnë se institucionet e shërbimit shëndetësor zhvillojnë veprimtarinë e tyre në ndërtesa me moshë 6 – 35 vite. Në grafikun e *figurës 26* tregohet lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe izolimit të tyre. Nga përgjigjet e marra gjatë punës në terren është vënë re se vetëm dy kanë qenë përgjigjet e dhëna për izolimin. Këto ndërtesa ose kanë izolim të plotë (mure, çati, dysheme) ose nuk kanë izolim. Gjithashtu vihet re se në të gjithë institucionet që ofrojnë shërbime shëndetësore të marra në studim numri i ndërtesave që nuk kanë izolim është më i lartë tek ato me vjetërsi 26 – 35 vite duke arritur shifrën 89%.

Këto shifra së bashku me të dhënat e Tabelës nr. 5 ku tregohet se ky grup institucionesh shpenzojnë rreth 1.5 % për pagesën e energjisë elektrike, janë tregues i nevojës për të ndërhyrë në izolimin e tyre.

Përqindja e lartë e buxhetit që shkon për pagesën e energjisë elektrike në këto institucione shpjegohet edhe më tej nga prania e lartë e dyerve dhe dritareve ku kalojnë rryma ajri. Afërsisht 89% e ndërtesave me moshë 26 – 35 vite, si dhe 64% e ndërtesave me moshë 6 – 25 vite kanë prani të dyerve dhe dritareve ku kalojnë rryma ajri (*figura nr. 27* dhe *nr. 28*). Duke qenë institucione të kujdesit shëndetësor, nevojiten masa sa më të shpejta për të përmirësuar këtë situatë.

DRITARE KU KALOJNË RRYMA AJRI



Figura nr. 27. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe pranisë së dritareve ku kalojnë rryma ajri.

DYER KU KALOJNË RRYMA AJRI



Figura nr. 28. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe pranisë së dyerve ku kalojnë rryma ajri.

Në *figurën nr. 29* dhe *nr. 30* tregohen tipi i xhamave dhe korniza që kanë dritaret e këtyre institucioneve. Ndërtesat me moshë 26 – 35 vite paraqesin ngjashmëri duke patur të gjitha kornizë alumini dhe xhama dopio. Grupi tjetër i ndërtesave tregon edhe praninë e xhamave teke me 27%, si dhe kornizë metalike me 9%.

2.2 HOTELE

Në *figurën nr. 31* tregohet lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe shkallës së izolimit të tyre. Hotelet e marra në studim i përkasin të gjithë sektorit privat. Të dhënat tregojnë një trend rritës për izolimit të plotë në ndërtimet e 60 viteve të fundit. Gjithë ndërtesat e 5 viteve e fundit kanë izolim të plotë. Nivelin më të lartë të mungesës së izolimit e kanë ndërtesat me vjetërsi 6 – 25 vite. Studimi tregon se janë marrë masa për izolim edhe në ndërtesat më të vjetra se 60 vite. Në këtë grup rreth 33% e ndërtesave janë izoluar plotësisht dhe 33% janë pjesërisht të izoluara.

Nga analiza për praninë e dritareve dhe dyerve ku kalojnë rryma ajri duket se pjesa më e madhe e hoteleve nuk kanë të tilla (*figura nr. 32* dhe *nr. 33*).

IZOLIMI I NDËRTESËS



Figura nr. 31. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe izolimit të tyre.

Gjithë ndërtesat e 5 viteve të fundit nuk kanë as dritare dhe as dyer ku kalojnë rryma ajri. Ndër grupet e tjera, në gjendje më të mirë janë ato me vjetërsi 26 – 35 vite, ku 75% e tyre nuk kanë prani të dyerve apo dritareve ku kalojnë rryma ajri. Të dhënat e mbledhura tregojnë se numrin më të lartë të dyerve dhe dritareve ku kalojnë rryma ajri e kanë ndërtesat me moshë 26 – 35 vite, me 47% të tyre, ndjekur nga ato me moshë 36 – 60 vite (38%). Për këto dy tipare, duket se për ndërtesat më të vjetra se 60 vite janë marrë masa, ku 67% nuk kanë prani të dyerve apo dritareve ku kalojnë rryma ajri.

TIPI I XHAMAVE NË DRITARE



Figura nr. 29. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe tipit të xhamave në dritare.

KORNIZA E DRITARES



Figura nr. 30. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe materialit të kornizës së dritares

DRITARE KU KALOJNË RRYMA AJRI



Figura nr. 32. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe pranisë së dritareve ku kalojnë rryma ajri.

DYER KU KALOJNË RRYMA AJRI



Figura nr. 33. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe pranisë së dyerve ku kalojnë rryma ajri.

Ndërtesat e mbi 60 viteve më parë tregojnë një rezultat homogjen (*figura nr. 34 dhe nr. 35*) ku të gjitha janë të pajisura me kornizë alumini dhe xhama dopio në dritaret e tyre. Prania e kornizës prej druri dhe xhamave teke vërehet tek të gjithë hotelet me moshë më të re, me numrin më të lartë në ato të ndërtuara 5 vitet e fundit (33%). Gjithë ndërtesat me 26 – 35 vite vjetërsi tregojnë praninë e xhamave dopio dhe 94% e tyre kanë kornizë alumini. Konizat metalike në dritare gjenden në numër të vogël dhe vetëm tek ndërtesat me 6 – 25 vite vjetërsi (3% e tyre). Ky grup, si dhe ai me vjetërsi 36 – 60 vite janë të vetmit që kanë marrë masa për izolimin e xhamave ne dritare.

TIPI I XHAMAVE NË DRITARE



Figura nr. 34. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe tipit të xhamave në dritare.

KORNIZA E DRITARES



Figura nr. 35. Lidhja ndërmjet moshës së ndërtesave dhe materialit të kornizës së dritares.

2.3 TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Numri i përgjithshëm i institucioneve të marra në studim është 191. Nga të dhënat e studimit rezulton se secila ndërtesë ka një sipërfaqje mesatare prej 1050 m^2, dhe numri i personave në ndërtesë është mesatarisht 569. Në qytetin e Tiranës studimi është kryer gjatë muajve gusht – shtator 2017. Gjatë kohës kur janë plotësuar pyetësorët është bërë matja e temperaturës brenda ndërtesës dhe jashtë saj, e cila ka rezultuar në një mesatare prej 31.6 °C dhe 23.9 °C përkatësisht, duke treguar mesatarisht një diferencë prej 7.7 °C.

Pjesa më e madhe e punonjësve të intervistuar në këto institucione (rreth 85%) shprehen të kënaqur me temperaturën brenda ndërtesës gjatë muajve të dimrit, kundrejt atyre që shprehen se është shumë ftohtë (10%) apo shumë nxehtë (5%). Këta punonjës janë pyetur edhe për cilësinë e ajrit brenda ndërtesës. Nga analiza rezulton se 83% shprehen të kënaqur, ndërkohë që 13% thonë se ajri është shumë i lagësht dhe 4% shumë i thatë. Një tregues tjetër i rëndësishëm është se rreth 30% e ndërtesave të marra në studim në qytetin e Tiranës kanë probleme me mykun.

Rëndësia e karakteristikave të ndërtesës si prania e dyerve apo dritareve ku kalojnë rryma ajri, shkalla e izolimit, tipi i xhamave, etj., ndikojnë në efiçencën energjetike të godinës së institucionit e më pas në faturën e energjisë elektrike. Në rastin e institucioneve publike, kjo faturë paguhet pjesërisht nëpërmjet të ardhurave që mbidhen nga taksa-paguesit. Marrja e masave për të patur ndërtesa publike me performancë më të lartë energjetike do të ndikonte pozitivisht si në vetë buxhetin e institucionit, ashtu edhe në shëndetin e punonjësve që kalojnë pjesën më të madhe të ditës aty. Këtu nuk duhen anashkaluar edhe masat që duhen ndërmarrë për rritjen e efiçencës së energjisë nga biznesi privat, duke qenë ata konsumatorë të rëndësishëm të energjisë.

2.4 PËRDORIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Si edhe për njësitë ekonomike familjare, ashtu edhe për ndërtesat me karakter institucional, energjia elektrike zë vendin kryesor në sigurimin e shërbimeve. Është marrë në studim përdorimi i energjisë elektrike duke e parë si mënyrë për të vlerësuar se cilat janë mundësitë e përmirësimit të infrasrukturës me qëllim uljen e përdorimit të energjisë elektrike, diversifikimin e burimeve të energjisë dhe uljen e shpenzimeve për energji elektrike në institucion.

Në bazë të këtij studimi rezulton se 83% e institucioneve përdorin energjinë elektrike për ngrohje dhe 82% për ftohje (*figura nr. 36*). Për më tepër, energjia elektrike përdoret pjesërisht për ngrohje nga 11% e ndërtesave dhe për ftohje nga 12%. Nga njëra anë, ky është një tregues që duhen marrë masa për diversifikimin e burimeve të energjisë në sistemin ngrohje-ftohje. Nga ana tjetër, ajo që bie në sy është mungesa e sistemeve qendrore të ngrohjes në institucione, gjë e cila çon në përdorim të shkallës së lartë së energjisë elektrike për sigurimin e shërbimeve.



Figura nr. 36. Përdorimi i energjisë elektrike për ngrohje dhe për ftohje në institucion.

Përdorimi i energjisë elektrike si i vetmi burim, theksohet edhe më tepër kur vlerësohet ngrohja apo pompimi i ujit. Sipas rezultateve të anketimit, 69% e institucioneve pjesë e studimit tonë përdorin energjinë elektrike për ngrohjen e ujit në krahasim me 30% të cilët e ngrohin ujin me mënyra të tjera. Po ashtu, janë 88% e punonjësve të anketuar, të cilët shprehen se përdorin energjinë elektrike për pompimin e ujit (*figura nr. 36*).

Në *figurën nr. 37* tregohen mënyrat që përdoren për ngrohjen e ujit në banjë në 191 institucionet e analizuara. Duket se pjesa më e madhe e tyre edhe këtu përdorin energjinë elektrike (63%). Vetëm 7% kanë ngrohje qendrore, të ndjekur nga ndërtesa të cilat përdorin energjinë diellore për ngrohjen e ujit (4%) dhe ato të cilat përdorin boiler me gaz (1%). Një pjesë e mirë e institucioneve nuk ngrohin ujë në banjë (25%).

Ndeshet një numër edhe më i vogël i institucioneve që përdorin ngrohje qendrore (3%) dhe energjinë diellore (3%) në kuzhinën e tyre (*Figura nr. 38*). Pjesa më e madhe (47%) ngrohin ujin me energji elektrike. Po ashtu, një pjesë e mirë e institucioneve nuk e ngrohin ujë në kuzhinë (46%).

NGROHJE E UJIT NË BANJË



Figura nr. 37. Përdorimi i energjisë elektrike për ngrohjen e ujit në banjë.

NGROHJE E UJIT NE KUZHINË



Figura nr. 38. Përdorimi i energjisë elektrike për ngrohjen e ujit në kuzhinë.

Përfaqësuesit e institucioneve janë pyetur nëse gjatë dimrit të vitit 2016 – 2017 kanë ndërmarrë veprime të ndryshme për reduktimin e konsumit të energjisë elektrike me qëllim reduktimin e kostos. Në figurën nr. 39 jepen të dhënat nga përgjigjet e marra. Duket se në pjesën më të madhe të istitucioneve në qytetin të Tiranës nuk merren masa për reduktimin e konsumit të energjisë elektrike. Rreth 64% e të intervistuarëve shprehen se nuk e fikin ngrohjen dhe 58% nuk e reduktojnë atë. Për më tepër, 49% e institucioneve të marra në studim ngrohin edhe ambientet të cilat nuk kanë përdorim të drejtpërdjet gjatë punës së tyre (korridorin dhe ambientet nuk nuk punohet). Krahasuar me njësitë ekonomike familjare, në të cilat rezulton se 80% e familjeve kufizojnë qëndrimin e tyre vetëm në një dhomë në varësi të periudhës së ditës, kuptohet që nevojitet një punë më e mirë ndërgjegjësuese ndaj punonjësve të institucionëve në fjalë për të rritur sjelljet me qëllim kursimin e energjisë.

SJELLJET PËR REDUKTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE (%)



Figura nr. 39. Masat e marra për reduktimin e konsumit të energjisë elektrike gjatë dimrit të vitit 2016-2017.

2.5 KOSTOJA E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në *tabelën nr. 5* paraqiten të dhënat në lekë për secilën kategori të institucioneve mbi tarifën mesatare vjetore të energjisë elektrike, buxhetin mesatar vjetor dhe pjesën e buxhetit total të institucionit që shkon për pagesën e energjisë elektrike. Për sa i përket hoteleve, si buxhet total është paraqitur xhiro vjetore e tyre. Ajo që bie në sy është se institucionet e shërbimit shëndetësor çojnë rreth 1.5% për pagesën e energjisë elektrike, ndërkohë që instutucionet e administratës publike çojnë vetëm 0.25% të buxhetit të tyre vjetor për pagesën e energjisë elektrike.

Një shifër tjetër që tërheq vëmendjen është se më shumë se gjysma e hoteleve të marra në studim (37) përdorin vetëm energjinë elektrike për gatim. Duke patur parasysh tipologjinë e shërbimeve që ofrojnë këto biznese, përdorimi i energjisë elektrike si i vetmi burim në kuzhinë është një peshë e madhe për konsumin e përgjithshëm të energjisë elektrike në Tiranë. Nevojiten ndërhyrje ndërgjegjësuese për diversifikimin e burimeve të energjisë për gatim në institucionet që ofrojnë shërbimet e hotelerisë.

Nga të dhënat e siguruara për qytetin e Tiranës duket se pjesa më e madhe e institucioneve nuk hasin vështirësi në pagesën e faturës së ujit, energjisë elektrike, gazit dhe ngrohjes (figura nr. 40). 85% e të intervistuarve shprehen se nuk kanë vështirësi në pagesën e faturës për energjinë elektrike, shifër kjo që pritej më e lartë duke konsideruar përqindjen e ulët që zë fatura e energjisë elektrike në buxhetin vjetor. Kjo mund të shpjegohet me buxhetet e ulta që kanë institucionet publike për kryerjen e shërbimeve. Pra, nuk duhen nënvlerësuar shifrat që tregojnë se 6% e institucioneve kanë vështirësi në pagesën e faturës së energjisë elektrike, e ndjekur kjo nga fatura e ujit (4%), ngrohja (2%) dhe gazi (rreth 2%), e si rrjedhim masat që duhen ndërmarrë për të ulur këto shifra.

INSTITUCIONI	TARIFA MESATARE VJETORE E ENERGJISË ELEKTRIKE (LEKË)	BUXHETI MESATAR PËR INSTITUCIONET (LEKË)	PJESA E BUXHETIT TË INSTITUCIONIT QË SHKON PËR FATURËN E ENERGJISË ELEKTIKE (%)
Institucione të edukimit publik	2.288.622	76.049.041	3.01
Administrata publike	5.424.451	2.136.850.440	0.25
Spitale publike, qendra shëndetësore, poliklinika, klinika private [20]	1.004.398	1.461.500	1.5
Hotele [21]	1.955.492	4.550.000	1.5

Tabela nr. 5. Pjesa e buxhetit të secilit grup të institucioneve e cila shkon për faturën e energjisë elektrike

20 Në kategorinë e institucioneve të shërbimit shëndetësor, vetëm tre prej tyre kanë treguar buxhetin mesatar te tyre. Mostra nuk është përfaqësuese dhe besueshmëria statistikore është më e vogël se 95%.

21 Në kategorinë e hoteleve, vetëm tre prej tyre kanë treguar buxhetin mesatar te tyre. Mostra nuk është përfaqësuese dhe besueshmëria statistikore është më e vogël se 95%.

Por si do të ndryshonin këto shifra në rast se ofrohet i njëjti shërbim në çdo ambient të ndërtesës? 51% e institucioneve tregojnë se ngrohin vetëm ambientet ku punohet (fig. nr. 40), ndërkohë që 2% kanë vështirësi në pagësën e faturës për ngrohje (fig. nr. 40). Ky rezultat na bën të mendojmë se sa do të ndryshonte përqindja e buxhetit të institucionit në rast se ngrohja do të ishte e njëjtë në secilën hapësirë të institucionit. Për më tepër, a do të rritej përqindja e institucioneve të cilat kanë vështirësi në pagesën për ngrohje në këtë situatë?

***

VËSHTIRËSI NË PAGESËN E FATURËS



Figura nr. 40. Vështirësi në pagesën e faturës së shpenzimeve në institucione.

Ligji që adreson qartazi nevojën dhe standardet e ndërtesave për të rritur përformancën e tyre të energjisë u miratua në 2016 dhe është ligjin nr. 116/2016 "Për performancën e energjisë në ndërtesa". Në këtë kuadër, të gjithë të intervistuarit u pyetën nëse kishin dëgjuar për të dhe detyrimet që ai sjell. ***Rreth 70 % e tyre u përgjigjën JO.***

***

INTERFERENCA

Në këtë hapësirë prezantohen gjetje të tjera të grupit të punës, jo të lidhura drejtpërdrejt me qëllimin dhe kategoritë e informacionit të pyetësorit, por të perceptuara nga vëzhgimet dhe bashkëbisedimet më të gjera me intervistuesit:

Gjatë vizitave në terren për plotësimin e pyetësorëve përveç përcjelljes së informacioneve ndërgjegjësuese për efiçencën e energjisë, janë bërë edhe biseda me qytetarët e intervistuar për jetën e tyre të përditshme. Në pjesën më të madhe të familjeve në qytetin e Tiranës është parë se ka pakënaqësi për koston e faturës së energjisë elektrike në familje e cila konsiderohet e lartë duke patur parasysh konsumin e energjisë elektrike. Të shumta ishin veprimet që merreshin për të kursyer elektricitetin. Ajo që është vënë re, në nivel më të lartë ndër të moshuarit është mbajtja fikur e ngrohjes gjatë muajve të dimrit edhe kur ata do të dëshironin të ishte ndezur. Kjo në pjesë të madhe zëvendësohej me përdorimin e batanijeve dhe shisheve me ujë të ngrohtë. Megjithëse këto masa të lidhura krysisht me ngrohjen merren për të kursyer, nga vlerësimi rezulton se ngrohja e ujit ka ndikim të rëndësishëm në faturën e energjisë elektrike.

Nga vizitat në familjet vulnerabël është parë se kushtet e jetesës së disa prej tyre ishin në skajin e së pranueshmes. Në disa raste xhamat në dritare mungonin plotësisht duke u zëvendësuar me dërrasa, kartona apo qese. Në pjesën më të madhe të banesave myku ishte i dukshëm në mure. Dhoma ndriçohej nga një llambë e cila lidhej në tavan me dy fije elektrike të veshura vetëm me një shtresë ngjitës. Kjo paraqet rrezik jo vetëm për familjarët që banojnë aty, por edhe për të gjithë bllokun e banimit pasi mund të jetë shkak për zjarre në ndërtesë.

Gjatë bisedave që janë zhvilluar me familjarët, janë ngritur disa problematika lidhur me gjendjen e tyre shëndetësore. Në njërën prej familjeve vulnerabël, zonja e shtëpisë, mamaja e tre fëmijëve nuk arrinte të përfitonte shërbimet shëndetësore falas pasi nuk arrinte të pajisej me kartën e shëndetit. E regjistruar si pjesë e familjeve në nevojë, kur paraqitej në qendrën shëndetësore të lagjes për të bërë kërkesën e pajisjes me kartë shëndeti, e dërgonin nga njëra zyrë në tjetrën duke mos i dhënë zgjidhje. Në kohën kur është kryer vlerësimi, kjo situatë zgjaste prej rreth 8 muajsh. E pyetur për gjendjen e shëndetit të saj, ajo nuk dinte të jepte një përgjigje. Ajo u shpreh se nuk ndihej mirë, por nuk e dinte çfarë kishte duke mos patur mundësi të bënte kontrollin shëndetësor falas, si dhe nuk mund të përballonte ekonomikisht një kontroll me pagesë.

Situata me të cilën u ndeshëm në njërën prej familjeve në nevojë ishte tepër e vështirë. Kjo familje kishte 7 vite pa energji elektrike në banesë. Ngrohja, gatimi në këtë shtëpi bëhej me gaz dhe ndriçimi me qiri. Mund të kuptohet se sa jashtë realitetit të kësaj familje ishte studimi për përdorimin efiçent të energjisë. Nga biseda me kryefamiljaren ajo kishte kërkuar shumë herë pranë zyrave përgjegjëse të pajisej me matës të energjisë elektrike. Përgjigjja që i jepej ishte se do të merreshin masa për këtë, por deri në atë kohë problemi i saj nuk kishte marrë asnjë zgjidhje.

Gjatë intervistave u vu re edhe se familjeve nuk është se i mungonte njohuria apo informacionin mbi efiçencën e energjisë si dhe përfitimet ekonomike që që vinin nga përdorimi i llampave LED (llampave me diodë elektroluminishente). Ekzistonin familje ku fatura e energjisë elektrike vinte ende aforfe, si vijim kostoja e faturës së energjisë elektrike nuk tregon realisht konsumin e energjisë elektrike të këtyre familjeve. Në lidhje me konsumin e druve të cilët përdoren për ngrohje, por dhe për gatim etj. nga përceptimet e anketuesve vlerat si për sasinë e drurit që konsumohet dhe shuma që paguhej për dru nuk tegonin realitetin duke supozuar se ka mjaft paligjshmëri në konsumin e druve. Pavarësiht vështirësive ekonomike apo ankesave për faturën e enrgjisë elektrike në përqindje të rritur të anketuesrit shpreheshim për detyrimin e pagesës mujore të energjisë elektrike si një domosdoshmëri, ku mund të kursenin në aktivitete të tjera jetësore, vetëm që në fund të muajit të paguanin faturën e energjisë elektrike.

Sigurimi i furnizimit të ujit përbënte një shqetësim në shumë familje nuk kishte furnizim uji, dhe mjaft të tjera e siguronin atë nëpërmjet puseve të ujit, atëherë dhe fatura e kostos së ujit nuk paraqeste realisht konsumin apo koston e faturës së ujit.

Përsa i përket kategorisë së institucioneve në qyetin e Tiranës mund të themi se gjendja e punonjësve është më e mirë krahasuar me përjetimin e familjarëve. E megjithatë, gjatë vizitave në qendrat shëndetësore dhe bisedës me punonjësit, dukej qartë pakënaqësia për lagështinë e ajrit dhe mungesën e ajrimit. Kjo mund të lidhet me faktin se ndërtesat që ofrojnë këto shërbime janë mjaft të vjetra dhe nuk është bërë shumë për rikonstruktimin e tyre. Nëse merret parasysh se ata punonjës kalojnë të paktën 40 orë në javë në këtë ambient, mund të kuptohet ndikimi negativ që ka në shëndetin e tyre.

Në institucionet e edukimit publik, gjendja e njërit prej kopshteve ishte mjaft e papërshtatshme. Çerdhja nr. 35 ishte rikonstruktuar vitet e fundit. Megjithatë ky rikonstruksion ishte vetëm sipërfaqësor, gjë e cila ngrihej si problematikë nga punonjësit. Në kohën kur është kryer intervista muret kishin filluar të pësonin çarje për shkak të lagështisë së lartë (*foto nr. 1*). Kjo ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e ajrit, si dhe në shëndetin e punonjësve dhe të fëmijëve që kalojnë një pjesë të madhe të ditës aty.

Foto nr. 1. Myk i dukshëm në mur, "Kopshti nr. 35", Tiranë

PËRFUNDIME

NJËSI EKONOMIKE FAMILJARE

Tipologjia e banesës

- Banesat e ndërtuara kryesisht në 6 - 25 vitet e fundit apo dhe ato pas viteve 1990, paraqiten banesat me kushte më të mira lidhur me izolimin e tyre. Në lidhje me praninë e xhamave dopio dhe përputhshmërinë e dritareve dhe dyerve që pengojnë kalimin e rrymave të ajrit, gjendjen më të mirë e tregojnë ndërtesat e 5 viteve të fundit.
- Banesat e vjetra kryesisht më shumë se 60 vjeçare, por dhe ato të ndërtuara pas viteve 1957 janë banesat të cilat shfaqen më problematike në lidhje me tiparet e mësipërme.

Përdorimi i energjisë elektrike

- Energjia elektrike përdoret gjerësisht për ngrohjen e ujit duke patur dhe përdorimin më të madh për këtë domosdoshmëri jetësore. Energjia elektrike përdoret më shumë për ngrohje sesa për ftohje megjithatë nuk vihet re një diferencë e ndjeshme midis dy përdorimeve.
- Energjia diellore edhe pse në nivel të ulët është e përdorur nga familjet kryesisht për ngrohjen e ujit si një alternativë me leverdi dhe miqësore me mjedisin.
- Vlerësimi është zhvilluar në zonat urbane megjithatë vihet re se përdorim i biomasës është i pranishëm për ngrohje në masën 38%.
- Përdorimi i energjisë elektrike për pompimin e ujit është në vlerën 69% (e krahasueshme më përdorimin e energjisë për ngrohjen e ambientit 68%) duke treguar që faturës së energjisë i shtohet dhe kostoja për sigurimin e furzinimit me ujë.

Kostoja e energjisë elektrike

- Familjet me të ardhura mujore më të larta kanë kosto mesatare mujore të energjisë elektrike më të lartë në krahasim me familjet me të ardhura mujore më të ulta. Ndërkohë që fatura e energjisë elektrike ka peshë më të madhe te familjet me të ardhura të ulta. Në familjet me të ardhura mesatare mujore nën 10 000 lekë, jo më pak se 48% e të ardhurave shkon për faturën e energjisë elektrike dhe për familjet me të ardhura mesatare mujore mbi 50 000 lekë jo më shumë se 13% e të ardhurave shkon për faturën e energjisë elektrike.
- 42% e familjeve të intervistuara kanë vështirësi në pagesën e faturës së energjisë elektrike, ndërkohë që 33% hasin vështirësi në pagesën e faturës së ujit.
- Pavarësisht të ardhurave mesatare mujore 67% e të gjitha familjeve ndërrmarrin veprime për të zvogëluar faturën e energjisë elektrike.

NJËSI TË TJERA

Tipologjia e ndërtesës

- Institucionet e administrates publike janë njësia me izolimin e plotë më të ulët, të ndjekura nga institucionet e edukimit. Ndërtesat institucioneve të shërbimit shëndetësor kanë nivelin më të lartë të mungesës së izolimit, të ndjekura nga hotelet.
- Ndërtesat e administratës publike të ndërtuara ndërmjet viteve 1982-1991 kanë përqindjen më të lartë të mungesës së izolimit. Institucionet e edukimit publik të ndërtuara 5 vitet e fundit kanë përqindjen më të lartë të mungesës së izolimit në krahasim me vitet e tjera të vlerësuara.
- Mbizotërojnë xhamat tek në ndërtesat e Administratës publike, ndërkohë që në tre kategoritë e tjera paqariten në shifër më të lartë xhamat dopio. Tek të të gjitha njësitë e vlerësuara mbizotëron korniza prej alumini. Ndërkohë që rrymat e ajrit që kalojnë në dyer dhe dritare janë kryesisht të pranishme në institucionet e shëndetit publik.
- Hotelet paraqiten si njësia në nivelet më të mira në lidhje me karakteristikat e mësipërme.

Përdorimi i energjisë elektrike

- Energjia elektrike ka përdorimin më të madh për ngrohjen e ambientit dhe për pompimin e ujit. Ndërkohë që ngrohja e ujit zë përqindjen më të ulët të përdorimit të energjisë elektrike.
- Vetëm 7% e ndërtesave të njësive ekonomike jo-familjare janë të pajisura me ngrohje qendrore.

Kostoja e energjisë elektrike

- Afërsisht 85% të institucioneve nuk kanë vështirësi në pagesën e faturës së energjisë elektrike, dhe kostoja e faturës së energjisë elektrike (përveç njësisë institucione të edukimit publik) nuk zë një përqindje të ndjeshme në buxhetin vjetor të institucionit). Ndërkohë 63% kryejnë veprime për të zvogëluar koston e energjisë elektrike.
- Institucionet ndërmarrin më pak veprime për të zvogëluar konsumin e energjisë elektrike në krahasim me familjet.

REKOMANDIME

- Në kushtet e përshkruara më sipër, në të cilat gjenden ndërtesat në vendin tonë pavarësisht shërbimeve që ofrojnë (familje, edukim, shëndet, etj.) vëmendje parësore duhet ti kushtohet rinovimit të tyre brenda standadeve të efiçencës. Të nxiten praktikat e mira të investimeve nga pushteti vendor, si dhe hartimi i politikave qendrore të rinovimit të ndërtesave aktuale. Është thelbësore për kushtet minimale të domosdoshme të një qytetari.
- Fushata të gjera dhe afatgjata informimi me banorët për efiçencën e energjisë janë të rëndësishme për të patur një komunitet të ardhshëm që kupton efiçencën dhe punon për ta zbatuar dhe ruajtur atë.
- Duhen përmirësuar politikat sociale të cilat ndihmojnë shtresat e familjeve me të ardhura të ulta për përballimin e nevojave bazë jetësore dhe të zhduken informalitetet.

SHTOJCA

1. **Informacion për organizatat e rrjetit të vigjilencës mjedisore që kanë kryer studimin në Tiranë**

Qendra Mjedisore për Zhvillim Edukim dhe Rrjetëzim (Qendra EDEN) – organizata udhëheqëse e rrjetit

Rr. "Bogdani", Nd.13, H.1, Ap.8, Njësia bashkiake 10, Tiranë, Shqipëri

www.eden-al.org

eden@eden-al.org

04 22 27 615

Qendra EDEN/EDEN center

Qendra për Mbrojtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri (EcoAlbania)

Rr. Kavajës, P. Qendra Tregtare "GLOBE", Ap. 11/3, Tiranë, Shqipëri

www.ecoalbania.org

contact@ecoalbania.org

04 43 17 720

EcoAlbania

2. Fotografi nga vizitat në terren

Foto nr. 2. Gjatë plotësimit të pyetësorëve në familjet e rastësishme Tiranë.



Foto nr. 3 Gjatë vizitës në Kopshtin nr. 29, Tiranë.

Foto nr. 5 Gjatë plotësimit të pyetësorëve në familjet e rastësishme, Tiranë.

Foto nr. 4 Gjatë plotësimit të pyetësorëve në familjet vulnerabël, Tiranë.



Foto nr. 6 Gjatë plotësimit të pyetësorëve tek qendra shëndetësore e specialiteteve “Dispanceria”, Tiranë.

RAPORT

VLERËSIMI I PERFORMANCËS
SË ENERGJISË NË NDËRTESA
PËRMES KONCEPTIT TË
VARFËRISË ENERGJETIKE

"Ky raport vlerësues është kryer paralelisht në qyetete Shkodër, Vlorë, Elbasan dhe Berat nga organizatat partnere të rrjetit të OJF-ve për Vigjilencë mjedisore"

NJË SY PËR MJEDISIN!

Klubi Ekologjik, Elbasan KEE
Ecological Club, Elbasan ECE

Për Mirëqënie Sociale e Mjedisore

AARHUS
INFORMATION CENTER

Qendra për Kërkim Bashkëpunim dhe Zhvillim

EcoAlbania

Qendra për Mbrojtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri (EcoAlbania)
Rr. Kavajës | P. Qendra Tregtare "GLOBE" | Ap. 11/3 | Tiranë | Shqipëri
www.ecoalbania.org
contact@ecoalbania.org
04 43 17 720
EcoAlbania